



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit

Zyra e Kryetarit

01-Nr 020-3679 dt. 18.01 2023



Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqverisjen Lokale, nenit 15 të Ligjit Nr.08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, nenit 4 të rregullores 01-01-2023 për funksionimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit, nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 të datës 24.09.2008, nxjerr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR REGJISTRIM

I. Formohet Komisioni Komunal për Regjistrim (KKR), në këtë përbërje:

1. Ramiz Lladrovci, kryetar i komunës, Kryesues;
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës, përfaqësues
3. Arben Kuliqi, përfaqësues nga Shoqëria Civile;
4. Flutura Avdiu, anëtar;
5. Muhamet Gjoka, anëtar;
6. Skender Berisha, anëtar;
7. Enkela Dema, anëtar;
8. Bekim Dobra, anëtar;
9. Besart Bajrami, anëtar;

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKR-së:

1. Siguron hapësirat për trajnime dhe aktivitetet e tjera (3) muaj para datës së fillimit të Regjistrimit, siguron së paku një zyrë për një periudhë dy (2) mujore para, gjatë Regjistrimit dhe një periudhë dy (2) javore pas Regjistrimit.
2. Ofron ndihmë teknike gjatë trajnimeve, merr pjesë në trajnime, organizon dhe realizon projektin e Regjistrimit në komunë, duke marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;
3. Zbaton rekomandimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës;

4. Merr pjesë në përzgjedhjen e regjistruessve në Komunë, sipas njoftimeve në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
5. Ndërhynë në çdo situatë që shfaqet si pengesë gjatë procesit të Regjistrimit;
6. Mbikqyrë regjistruessit, siguron funksionalizimin normal gjatë fazës së Regjistrimit;
7. Koordinon aktivitetet me mbikqyrësit dhe stafin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
8. Pranon, shpërndan dhe grumbullon materialet/dokumentet sipas njoftimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
9. Raporton çdo javë, lidhur me zhvillimin e procesit të Regjistrimit, brenda territorit të Komunës.

III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

 Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Anëtarëve të Komisionit Komunal për Regjistrim;
- Arkivit;